

NJOFTIM

PËR HAPJEN E KONKURRIMIT PUBLIK

Mbështetur në paragrafin 2 të nenit 4 të Rregullores “Për përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur”, të miratuar me Vendimin nr. 66, datë 07.11.2016 të Këshillit Drejtues të RTSH, Njësia e Programeve në RTSH shpall publikisht hapjen e konkurrimit publik për mbledhjen e projekteve nga subjektet e interesuara:

Objekti:	Financim i prodhimit të programeve të pavarura të transmetimit audioviziv
Forma e prodhimit:	Prodhim i porositur
Lloji i prodhimit audioviziv:	Prodhim filmik Dokumentar
Numri i dokumentarëve:	10 (dhjetë)
Kohëzgjatja e një dokumentari:	45 (dyzetëpesë) minuta deri në 50 (pesëdhjetë) minuta
Fondi financiar:	3,000,000.00 (tremilionë) lekë
Natyra e dokumentarëve:	Zhvillimi social, ekonomik, urbanistik dhe infrastrukturor i qyteteve shqiptare, që nga periudha e krijimit të shtetit shqiptar.
Grup-mosha:	Për të gjitha moshat
Vendi i prodhimit:	Republika e Shqipërisë
Gjuha:	Gjuha shqipe
Afatet e prodhimit:	90 (nëntëdhjetë) ditë, nga data e nënshkrimit të kontratës me RTSH
Periudha e transmetimit:	Transmetimi i parë i dokumentarit të parë: muaji Mars 2021
Formati i prodhimit:	16:9
Audio:	Stereo
Ngjyrat:	Me ngjyra
Të drejtat:	RTSH zotëron të gjitha të drejtat e shfrytëzimit pasuror të secilit prej dokumentarëve
Forma e të drejtave:	Ekskluzive
Kohëzgjatja e të drejtave:	E pakufizuar
Territori:	Republika e Shqipërisë si dhe të territoret e të gjithë shteteve të Botës
Numri i transmetimeve:	I pakufizuar

Personi fizik ose juridik i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Sektorit të Projekteve dhe të Administrimit të të Drejtave në RTSH brenda datës 05 Nëntor 2020, deri në orën 12:00, e cila duhet të përmbajë detyrimisht dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Përshkrimin narrativ të projektit, qëllimi dhe objektivat, anët pozitive e negative, projekt – buxheti i detajuar në zëra të veçantë dhe kostot e tyre;
2. Skenari/sinopsi i projektit;
3. Stafin e parashikuar për realizimin e projektit;
4. Ekstrakt i regjistrimit në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit);
5. Çertifikatë e regjistrimit pranë organeve tatimore;
6. Vërtetim nga organet tatimore, që subjekti i ka shlyer të gjitha detyrimet fiskale, përfshirë edhe detyrimet për sigurimet shoqërore, që kanë qenë në fuqi deri 28 ditë përpara paraqitjes së dokumentacionit;
7. Liçensa për ushtrimin e aktivitetit;
8. Vërtetim që nuk ka konflikt gjyqësor me RTSH;
9. Vërtetim nga Prokuroria që subjekti nuk është në ndjekje penale;
10. Deklaratë noteriale ku merr përsipër të gjithë detyrimet në lidhje me të drejtat e autorëve dhe të drejtat e tjera të lidhura me të për përdorimin e veprave të tyre në këtë projekt;
11. CV e subjektit;
12. Vendi i realizimit të projektit;
13. Deklaratë e personit fizik ose juridik që:

- (i) personat pjesëmarrës në program, apo të përfshirë në përgatitjen e tij dhe pajisjet e mjetet për realizimin e programit vendosen nga vetë personi fizik ose juridik;
- (ii) nuk është një transmetues audioviziv, pjesë e tij, apo aksionar në një transmetues;

Personi fizik ose juridik i interesuar, përveç dokumentacionit të kërkuar si më sipër, duhet të plotësojë formularin që përmban informacionin e domosdoshëm mbi projektin dhe subjektin aplikues.

Formulari mund të tërhiqet pranë Sektorit të Projekteve dhe të Administrimit të Drejtave në RTSH çdo ditë, nga ora 10:00 deri në orën 15:00.